



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 24.04.2013  
Nr. 0204 - 429

**PËR:** Blerim Kuçi, Kryetar i Komunës së Suharekë  
Veseli Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekë

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SUHAREKË, 01 Nr. 2323, Pranuar me datë, 08.04.2013**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 2323, të miratuar me datë 29.03.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr. 2323 Mbi ndarjen e parcelës kadastrale.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Dana: 23.04.2013

Br. 0204-429

Za: Blerim Kuçi, Gradonačelnik Opštine Suva Reka  
Veselj Malićaj, Predsedavajući Skupštine Opštine Suva Reka

**PREDMET: POTVRDA O ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE SUVA REKA,**  
**01Br.2323, Prilijeno dana, 08.04.2013.**

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke 01 br.2323, usvojene dana 29.03.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt niže naveden, ima puni pravni efekat .

- Odluka 01br.2323 o dodeli katastarske parcele.

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopija:** Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a  
Direktorima uprava  
Arhivi MALS-a.



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr-03/L-040, për Verëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 15, paragrafi 1, shkronja (b), 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 dhe konform nenit 20 të Ligjit për planifikimin hapësinor, nr-2003/14, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 29.03.2013, mori këtë:

VENDIM  
MBI NDARJEN E PARCELËS KADASTRALE

Neni 1

LEJOHET ndarja në proporcion 50:50 e parcelës kadastrale nr.2785/44, zona kadastrale Suharekë, sipas certifikatës së pronës, P-72116046-02785-44 e evidentuar pasuri shoqërore shfrytëzues i përhershëm KK Suharekë, vendi i quajtur "Shirokë", në sipërfaqe të përgjithshme 10,000m<sup>2</sup>, që me PRRU të Zonës Industriale në Shirokë, është në tërësinë T-7 e evidentuar me numër P-041.

Neni 2

Obligohet drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastrë që të bëjë ndarjen e parcelës dhe evidentimin në regjistrin kadastral sipas nenit 1, të këtij vendimi.

Neni 3

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis që të bëjë evidentimin e ndryshimit në PRRU të Zonës Industriale në Shirokë dhe në rast kërkesë të lëshoj leje ndërtimore konformë ndryshimit.

Neni 4

Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Planit Rregullues Urban të Zonës Industriale Shirokë.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis dhe Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastrë.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi verëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), nenit 18, të Rregullores, Nr-01/2013, për procedurat e hartimit dhe publikimit e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

01-Nr-8336  
Me datë 01.04.2013



Kryesuesi i Kuvendit

Veseli Maliqaj  
Veseli Maliqaj